



Pranimi - Përmirësimi Me Datë		17-03-2026	
Nr. Dokumenti (që llog)	Nr. Dokumenti	Nr. Dokumenti	Vlera
02	035/02	343	

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti



Në bazë të Rregullorës për Ndarjen e Bursave për Studentët e Komunës së Vitisë nr. 01-013/246 neni 3,6,8,9 dhe neni 10, si dhe buxhetit të planifikuar dhe të paraparë për këtë destinim, Komuna e Vitisë shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Vitisë për vitin akademik 2025/26

Komuna e Vitisë shpallë konkurs publik për ndarjen e **150** bursave, (vlera e një burse **300 €**), për vitin akademik **2025/26**. Bursat ndahen për studentë të rregullt, për studentë të drejtimeve deficitare (Matematikë, Fizikë, Gjuhë gjermane), për studentë të familjeve përfituese të ndihmës sociale, studentë të familjeve të dëshmorëve të luftës, invalid të luftës dhe veteranë të luftës, si dhe studentë të familjeve pa prindër në jetë.

Kriteret për aplikim:

- Të jenë student i rregullt me adresë banimi në Komunën e Vitisë,
- Të jenë studentë të rregullt në Universitete Publike të Republikës së Kosovës

- Përparësi do të kenë:

- Drejtimet deficitare: Matematikë, Fizikë, Gjuhë Gjermane,
- Studentët me notë mesatare më të lartë,
- Studentë të prindërve të kategorive të dala nga lufta,
- Studentë përfitues të ndihmës sociale,
- Studentë të familjeve pa prindër në jetë,
- Dy ose më shumë studentë të së njëjtës familje (përfitues do të jetë vetëm njëri nga studentët)

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Dokumenti i identifikimit (letërnjoftimi kopje),
- Certifikatë e vendbanimit,
- Certifikata e notave,
- Për studentët fillestar diploma e shkollës së mesme,
- Vërtetimi i regjistrimit të semestrit për vitin akademik 2025/2026,
- Dëshmi mbi gjendjen ekonomike (rastet sociale),
- Dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta,
- Studentët që janë pa prindër të sjellin certifikatën e vdekjes.
- Dëshmi që vërteton se dy ose më shumë studentë nga e njëjta familje e ngushtë (vëllezër ose motra) janë duke ndjekur studimet.
- Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës që nuk jeni të punësuar

Vërejtje: Nuk do të jenë përfitues të bursës komunale studentët përfitues të bursës universitare dhe bursave tjera, studentë të universiteteve private, studentë të niveleve postdiplomike (Master, PHD).

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Arkivin e Komunës në Viti, objekti tek Komuna e re.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, **ndërsa dokumentet e pakompletuara nuk merren në shqyrtim-do të refuzohen.**

Viti, më : 16.03.2026

Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Halit

